



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 241, Datë 03.08.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pika 7 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/3 prot., datë 02.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.07.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- ERE me e-mailin e datës 31.07.2023, ka kërkuar nga shoqëria që të depozitojë kontratën përkatëse të nënshkruar me MIE-n në vijim të miratimit të marrë prej saj dhe/ose aktin në të cilin MIE njeh shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. si shoqëria që do të operojë centralin fotovoltaik.
- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1964/2 prot., datë 01.08.2023, aplikuesi ka depozituar dokumentacion plotësues, nga i cili konstatohet se në vijim të marrjes së miratimit për ndërtim të dhënë nga MIE me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, Bashkimi i Përkohshëm i

Shoqërive, “2T” dhe “2B 1979” sh.p.k. ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 340 rep., nr. 1429 kol., datë 19.05.2023 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në zonën Grykë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “2T” shpk dhe “2B 1979” shpk”.

- Nga dokumentet e depozituara në ERE nga shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me e-mailin e datës 01.08.2023, konstatohet se dy shoqëritë e Bashkimit të Përkohshëm kanë rënë dakord për të krijuar shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e impiantit të ri gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike (gjë që përbën dhe objektin e vetëm të veprimtarisë së saj referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të QKB-së) dhe në asnjë nga dokumentet e këtij aplikimi nuk rezulton që kësaj shoqërie t’i njihet e drejta për të operuar këtë central.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 37, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, *ERE lëshon licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike*, ndërkohë që nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar nga aplikuesi me e-mailin e datës 01.08.2023, konstatohet se shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. i njihet e drejta e ndërtimit dhe jo e operimit të centralit fotovoltaike në vijim të marrjes së miratimit nga MIE për ndërtimin tij, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022.
- Në këto rrethana dhe në kuadër të mosplotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mos fillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në mbështetje të parashikimeve të nenit 10 pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dajeni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Nëse aplikuesi paraqet një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja dajeni e vendimit të bordit të ERE-s për mos fillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa e aplikimit do të konsiderohen të vlefshme edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Joint Venture 2 B 1979 dhe 2 T” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI